



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:221551

Datë: 02.06.2022

Numri i dokumentit: 03089467

P.nr.204/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL, gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me zyrtaren administrative Hatixhe Begaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarve: D. K., B. K. dhe B.K., që të tre nga fshati Ll., Komuna e M., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, veprës penale në bashkëkryerje të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale në bashkëkryerje të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe të akuzuarve: N.K., I.K. dhe E. K., që të tre nga fshati Ll., Komuna e M., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, veprës penale në bashkëkryerje të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale në bashkëkryerje të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP/II.nr.1342/2021 të dt. 30.09.2021, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, të dt. 07.03.2022, ku prezent ishin: Prokurori i shtetit Anton Hasanaj, të akuzuarit: D.K., B. K. dhe B. K., më dt.10.03.2022, nxjerri këtë:

A K T G J Y K I M

I. D. K. nga i ati R., e ëma R., e gjinisë G., i lindur më ... nga fshati Ll., Komuna e Malishevës, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, më parë i pa dënuar, i martuar atë i 2 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, fermer, me numër personal

II. B. K. nga i ati A., e ëma S., e gjinisë G., i lindur më ..., nga fshati Ll., Komuna e Malishevës, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, më parë i pa dënuar, i martuar, atë i 2 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, fermer, me numër personal

III. B. K. nga i ati A., e ëma S., e gjinisë G., i lindur më ..., nga fshati Ll., Komuna e Malishevës, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, më parë i padënuar, i martuar atë i 1 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, fermer, me numër personal

TË AKUZUARIT: D. K., B. K. DHE B. K.:

JANË FAJTORË

I. Më dt.12.05.2021 në fshatin D., Komuna e Malishevës, në mënyrë të kundërligjshme me dashje e përdorin forcën ndaj personit tjetër, në atë mënyrë që ditën kritike rreth orës 14:10/h, kishte shkuar i pandehuri D. K. për të punuar në arën e tij dhe gjersa ka punuar, ka kaluar në një pjesë të arës së të dëmtuarit N. K., në atë mënyrë me të parë kalimin e tij nëpër arë, ka reaguuar djali i N. K., I. K., ku i njëjti ka shkuar dhe i thotë: *“pse kalove ka ara ime, unë ta ndaloj me kaluar këndeje, ndërsa mua nuk më ndalon askush”*, në këtë mënyrë në fjalosje e sipër mes tyre dhe pasi të njëjtit kishin thirre edhe familjarët e tyre meqë kishin pasur fjalosje të mëhershme pronësore mes vete, në atë mënyrë të pandehurit pastaj e sulmojnë me grushte, shqelma, në kokë dhe në trup të dëmtuarin I. K., duke i shkaktuar kështu me dashje përmes forcës fizike sulmin fizik.

- me çka kanë kryer në bashkëkryerje veprën penale të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

II. Më datë, kohë, vend dhe mënyrë të përshkruar si në dispozitin e parë (I) të kësaj aktakuze, të pandehurit me dashje përdorin forcën fizike më anë të përdorimit të grushteve dhe shqelmave në trupin e të dëmtuarit N.K., duke i shkaktuar kështu të njëjtit në mënyrë të kundërligjshme dhimbje fizike në kokë dhe trupin e të dëmtuarit.

- me çka kanë kryer në bashkëkryerje veprën penale të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

III. Më datë, kohë, vend dhe mënyrë të përshkruar si në dispozitin e parë (I) dhe të dytë (II) të kësaj aktakuze, të pandehurit sulmojnë me anë të përdorimit të forcës fizike përkatësisht grushteve dhe shqelmave në kokë dhe trup të dëmtuarin E. K., me çka në mënyrë tek i njëjti në mënyrë të kundërligjshme shkaktojnë përmes forcës fizike sulmin fizik.

- me çka kanë kryer në bashkëkryerje veprën penale të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4, 6, 7, 17, 38, 39, 40, 43, 69,70, 76 par.1 dhe par.2 pika 2.4, e nenit 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe neneve 359 par.2, 365, 450 par.1 dhe 2 pika 2.1 dhe 2.6 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të njëjtit i :

G J Y K O N

PJESA DËNUESE PËR TË AKUZUARIN D. K.:

I. Për veprën penale në bashkëkryerje të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së si në dispozitivin e I-rë, e dënon me dënim me gjobë në shumë prej **dyqind (200) euro**.

II. Për veprën penale në bashkëkryerje të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së si në dispozitivin e II-të, e dënon me dënim me gjobë në shumë prej **dyqind (200)** euro.

III. Për veprën penale në bashkëkryerje të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së si në dispozitivin e III-të, e dënon me dënim me gjobë në shumë prej **dyqind (200)** euro.

Konform nenit 76 par.1 dhe 2 pika 2.4 të KPRK-së, gjykata të akuzuarit **D.K.** e gjykon me **DËNIM UNIK**:

DËNIM UNIK ME GJOBË në shumën prej gjashtëqind (600) euro, dënimin e shqiptuar me gjobë do ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditësh, duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro për një ditë burgu.

PJESA DËNUESE PËR TË AKUZUARIN B. K.:

I. Për veprën penale në bashkëkryerje të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së si në dispozitivin e I-rë, e dënon me dënim me gjobë në shumë prej **dyqind (200)** euro.

II. Për veprën penale në bashkëkryerje të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së si në dispozitivin e II-të, e dënon me dënim me gjobë në shumë prej **dyqind (200)** euro.

III. Për veprën penale në bashkëkryerje të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së si në dispozitivin e III-të, e dënon me dënim me gjobë në shumë prej **dyqind (200)** euro.

Konform nenit 76 par.1 dhe 2 pika 2.4 të KPRK-së, gjykata të akuzuarit **B. K.** e gjykon me **DËNIM UNIK**:

DËNIM UNIK ME GJOBË në shumën prej gjashtëqind (600) euro, dënimin e shqiptuar me gjobë do ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditësh, duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro për një ditë burgu.

PJESA DËNUESE PËR TË AKUZUARIN B. K.:

I. Për veprën penale në bashkëkryerje të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së si në dispozitivin e I-rë, e dënon me dënim me gjobë në shumë prej **dyqind (200)** euro.

II. Për veprën penale në bashkëkryerje të sulmit nga nenib184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së si në dispozitivin e II-të, e dënon me dënim me gjobë në shumë prej **dyqind (200)** euro.

III. Për veprën penale në bashkëkryerje të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së si në dispozitivin e III-të, e dënon me dënim me gjobë në shumë prej **dyqind (200)** euro.

Konform nenit 76 par.1 dhe 2 pika 2.4 të KPRK-së, gjykata të akuzuarit **B.K.** e gjykon me **DËNIM UNIK**:

DËNIM UNIK ME GJOBË në shumën prej gjashtëqind (600) euro, dënimin e shqiptuar me gjobë do ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësoj me dënim burgu në kohëzgjatje prej tridhjetë (30) ditësh, duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro për një ditë burgu.

Obligohen të akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia paguajnë shumën secili me nga 30 euro, si dhe secili shumën me nga 30 euro për programin mbi kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të behet me detyrim.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.1342/2021 të dt. 30.09.2021, i ka akuzuar të akuzuarit: D.K., B. K. dhe B. K., që të tre nga fshati Ll., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, veprës penale në bashkëkryerje të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale në bashkëkryerje të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe të akuzuarve: N.K., I. K. dhe E. K., që të tre nga fshati Ll., Komuna e M., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, veprës penale në bashkëkryerje të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale në bashkëkryerje të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar më dt. 07.03.2022, ku prezent kanë qenë: përfaqësuesi i akuzës, prokurori i shtetit Anton Hasanaj, të akuzuarit D.K., B.K. dhe B. K., ndërsa nuk kanë prezantuar të akuzuarit: N.K., I. K. dhe E. K., pasi që sipas raporteve të Stacionit Policor në M. të njëjtit gjenden në K.. Andaj me kërkesën e të akuzuarve dhe me qëllim të ekonomizimit dhe efikasitetit të procedurës penale, është veçuar procedura penale për të akuzuarve: N.K., I. K., dhe E. K., nga fshati Ll., Komuna e Malishevës, sipas aktvendimit P.nr.204/2021 të dt.07.03.2022, dhe për të njëjtit do të zhvillohet procedurë e veçantë, e cila lëndë ka marre numrin P.nr. 28/2022.

Prokurori i shtetit jep mendimin, se nuk e kundërshtoj pranimit e fajësisë nga ana e të akuzuarve, pasi që të njëjtit pranimet e fajësive i kanë bërë me vullnet të lirë dhe pasi i

kanë kuptuar favoret dhe pasojat e pranimit të fajësisë, po ashtu këto pranime gjejnë mbështetje edhe në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, nga të cilat prova është paraqitur gjendja faktike si në dispozitiv të aktakuzës, nga i cili dispozitiv formohen të gjitha elementet e veprave penale më të cilat ngarkohen të akuzuarit, andaj gjykatës i propozoi që të njëjtit ti shpallët fajtor, ti dënon sipas ligjit si dhe të obligohen në shpenzimet e procedurës penale njëherë të ketë parasysh rrethanat lehtësues dhe rëndues gjatë matjeve se dënimeve.

I akuzuari D. K. është deklaruar i fajshëm për të gjitha veprat penale për të cilat akuzohem, të njëjtat i pranoj në mënyrë vullnetare, kjo është hera e parë që i kam kryer këto vepra penale, dhe kërkoj nga gjykata që mundësisht të më dënoj më dënim më gjorbë.

I akuzuari B. K. është deklaruar i fajshëm për të gjitha veprat penale për të cilat akuzohem, të njëjtat i pranoj në mënyrë vullnetare, kjo është hera e parë që i kam kryer këto vepra penale, dhe kërkoj nga gjykata që mundësisht të më dënoj më dënim më gjorbë.

I akuzuari B. K. është deklaruar i fajshëm për të gjitha veprat penale për të cilat akuzohem, të njëjtat i pranoj në mënyrë vullnetare, kjo është hera e parë që i kam kryer këto vepra penale, dhe kërkoj nga gjykata që mundësisht të më dënoj më dënim më gjorbë.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike si në dispozitiv të aktgjykimit e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarit, të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajësitë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPRK-së. Gjatë pranimit të fajësisë, gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se të akuzuarit i kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: se të akuzuarit: D.K., B. K. dhe B. K. : më dt.12.05.2021 në fshatin D., Komuna e M., në mënyrë të kundërligjshme me dashje e përdorin forcën ndaj personit tjetër, në atë mënyrë që ditën kritike rreth orës 14:10/h, kishte shkuar i pandehuri D.K. për të punuar në arën e tij dhe gjersa ka punuar, ka kaluar në një pjesë të arës së të dëmtuarit N. K., në atë mënyrë me të parë kalimin e tij nëpër arë, ka reaguuar djali i N. K., I. K., ku i njëjti ka shkuar dhe i thotë: *“pse kalove ka ara ime, unë ta ndaloj me kaluar kënde, ndërsa mua nuk më ndalon askush”*, në këtë mënyrë në fjalosje e sipër mes tyre dhe pasi të njëjtit kishin thirrë edhe familjarët e tyre meqë kishin pasur fjalosje të mëhershme pronësore mes vete, në atë mënyrë të pandehurit pastaj e sulmojnë me grushte, shqelma, në kokë dhe në trup të dëmtuarin I. K., duke i shkaktuar kështu me dashje përmes forcës fizike sulmin fizik. me çka kanë kryer në bashkëkryerje veprën penale të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Më datë, kohë, vend dhe mënyrë të përshkruar si në dispozitivin e parë (I) të kësaj aktakuze, të pandehurit me dashje përdorin forcën fizike më anë të përdorimit të grushteve dhe

shqelmave në trupin e të dëmtuarit N.K., duke i shkaktuar kështu të njëjtit në mënyrë të kundërligjshme dhimbje fizike në kokë dhe trupin e të dëmtuarit. me çka kanë kryer në bashkëkryerje veprën penale të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Më datë, kohë, vend dhe mënyrë të përshkruar si në dispozitin e parë (I) dhe të dytë (II) të kësaj aktakuze, të pandehurit sulmojnë me anë të përdorimit të forcës fizike përkatësisht grushteve dhe shqelmave në kokë dhe trup të dëmtuarin E. K., me çka në mënyrë tek i njëjti në mënyrë të kundërligjshme shkaktojnë përmes forcës fizike sulmin fizik. me çka kanë kryer në bashkëkryerje veprën penale të sulmit nga neni 184 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Deklaratat e të pandehurve në cilësi të pandehur/të dëmtuar: D. K., B. K., B. K.si dhe N.K., I. K. dhe E. K., të dhëna në Stacionin Policor në M., me dt. 12.05.2021;
- Deklaratat e dëshmitarëve: A. K., A. K., D. K., L. K., të dhëna në SP M. me dt. 12.05.2021;
- Raporti fillestar i incidentit: A. B. me nr.#ID.... dt.12.05.2021;
- Raporti i oficerit: A. B. me nr.#ID.... dt.12.05.2021;
- Foto dokumentacioni si dhe shkresat e tjera në lëndë;

Duke u bazuar në këto që u cekën me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarit: D.K., B. K. dhe B. K., që të tre nga fshati Ll., Komuna e Malishevës, i ka shpallur fajtorë për veprat penale për të cilën ngarkohen, nga se në veprimet e tyre të përshkruara si në dispozitivet e aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprave penale të lartcekura, për këtë ka vendosur që të akuzuarit t'i gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69,70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të të akuzuarve, pranimin e fajësisë, të pa dënuar më parë, dhe ndaj tyre nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se D.K. për veprën penale si në dispozitivin I të aktgjykimit, e ka gjykuar me dënimin me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro për veprën penale si në dispozitivin II-të të aktgjykimit, e ka gjykuar me dënimin me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro, për veprën penale si në dispozitivin III të aktgjykimit, e ka gjykuar me dënimin me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro, andaj gjykata konform nenit 76 par.1 dhe 2 pika 2.4 të KPRK-së, gjykata të akuzuarin D. K. e ka gjykuar me dënimin unik – dënimin me gjobë në shumën prej gjashtëqind (600) euro, se B. K. për veprën penale si në dispozitivin I të aktgjykimit, e ka gjykuar me dënimin me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro për veprën penale si në dispozitivin II-të të aktgjykimit, e ka gjykuar me dënimin me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro, për veprën penale si në dispozitivin III të aktgjykimit, e ka gjykuar me dënimin me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro, andaj gjykata konform nenit 76 par.1 dhe 2 pika 2.4 të KPRK-së, gjykata të akuzuarin B. K. e ka gjykuar me dënimin unik – dënimin me gjobë në shumën prej gjashtëqind (600) euro, si dhe të akuzuarin B. K. për veprën penale si në dispozitivin I të aktgjykimit, e ka gjykuar me dënimin me gjobë në shumën prej dyqind

(200) euro për veprën penale si në dispozitivin II-të të aktgjykimit, e ka gjykuar me dënimin me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro, për veprën penale si në dispozitivin III të aktgjykimit, e ka gjykuar me dënimin me gjobë në shumën prej dyqind (200) euro, andaj gjykata konform nenit 76 par.1 dhe 2 pika 2.4 të KPRK-së, gjykata të akuzuarin B. K. e ka gjykuar me dënimin unik – dënimin me gjobë në shumën prej gjashtëqind (600) euro, e që me këto dënime do të arrihet efekti dhe qëllimi i tyre nga neni 38 të KPRK-së, dhe këto dënime të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprat penale të kryera dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit.

Vendimin mbi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale gjykata e mbështeti në nenin 450 par. 1 dhe 2 të KPPK-së.

Vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - DEGA NË MALISHEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.204/2021, më 10.03.2022.

Zyrtare administrative,
Hatixhe BEGAJ

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Njazi MORINA

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.